

VENDIM
Nr.143, datë 11.2.2009

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.338, DATË 19.3.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E MODELIT TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neni 53 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 9 të modelit të tregut të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr.338, datë 19.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, të ndryshuar, shtohet pika 10, me këtë përmbajtje:

“10. Dispozita tranzitore

Sa kohë që OSSH, sh.a.-ja, është shoqëri shtetërore, energjia elektrike, që prodhohet nga KESH, sha-ja, mbi kërkesën e furnizuesit publik me pakicë, i shitet OSSH, sh.a.-së, për mbulimin e humbjeve, në sasinë që kërkohet prej saj. Çmimi i shitjes do të jetë çmimi i miratuar nga ERE, për furnizuesin publik me pakicë, për vitin, në të cilin realizohet shitja.”.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe KESH, sh.a.-ja, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha